



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 18.09.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **16.09.2025**, të parashtruar nga **CMD SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN” Llot 2 - MEDLIS** me nr. prokurimi 206-25-5404-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE CMD SH.P.K. e dt. 16.09.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ritender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN” Llot 2 - MEDLIS** me nr. prokurimi 206-25-5404-2-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 12.09.2025;
2. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK i datës 12.09.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE Tech Vision shpk me datën 01.08.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ritender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN” Llot 2 – MEDLIS** me nr. prokurimi 206-25-5404-2-2-1. Autoriteti Kontraktues me datën 18.09.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 66 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 40, 41, 60, 64, i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik (me ndryshimet e 002/2024)

Pretendimet ankimore te OE ankues:

Ne, CMD SH.P.K., kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 12.09.2025 (Njoftimi B58), lidhur me aktivitetin e prokurimit, "Ritender 'Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN' Llot 2", me nr. prokurimi 206-25-5404-2-2-1.

Ne si Operator Ekonomik konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin tonë nga procedura e tenderimit është marrë mbi bazën e një interpretimi të gabuar dhe jo të drejtë të kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit, si dhe në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, përfshirë parimin e proporcionalitetit, transparencës dhe barazisë së trajtimit të operatorëve ekonomikë.

Kërkesa jonë për rishqyrtim bazohet në faktet dhe dokumentacionin zyrtar të dorëzuar gjatë procedurës, si dhe në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat qartë dëshmojnë përmbushjen e kriterëve të kërkuara nga ana jonë. Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë vendimin e marrë dhe të rivlerësojë ofertën tonë në përputhje me ligjin dhe dosjen e tenderit.

1.Arsyetimi i AK-Pika 1:

- Te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 – Kërkesa nr. 1 është kërkuar: *Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar se paku një projekt në zhvillimin dhe implementimin ose mirëmbajtje të softuerit e të paktën 1 (një) projekti në shëndetësi tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të këtij Njoftimit për kontratë.*

Ne Listën e projekteve të prezantuara nga OE CMD SH.P.K. është edhe projekti nr. 4 me titullin **Instalimi i programit financiar/kontabilitet, menaxherial dhe administrativ 2022-2024** në vlerë 5,980.00 euro për Ordinancën stomatologjike “Nika Dent”

Pas shqyrtimit me të detajuar të kërkesës së AK dhe dokumentacionit të ofertes, konsiderojmë se ka dallim substancial në mes titullit të projektit në listë dhe përshkrimit të bërë në reference. Sipas Listës projekti është realizuar nga 2022 deri në 2024, ndërsa referenca është lëshuar më dt. 01.06.2025 (pese dite para ofertimit 06.06.2025).

Për shqyrtimin me të detajuar të këtij projekti, kemi konsultuar dokumentacionin e ofruar nga kjo kompani në aktivitetin me titull “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ” për të cilin OE ka prezantuar sistemin e njëjte CMD-Financa, në të cilin nuk përfshihet përmbajtje e komponentave për shëndetësi, por është sistem financiar.

Kërkesa nga FDT:

Kapaciteti teknik dhe <u>professional</u> :	Dëshmia e kërkuar dokumentare
Kërkesa Për Lot-in 2.Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar se paku një projekt në zhvillimin dhe implementimin ose mirëmbajtje të softuerit e të paktën 1 (një) projekti në shëndetësi tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të këtij Njoftimit për kontratë.	Lot-in 2.Dëshmia Një listë të kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit, si dhe listës t’i bashkëngjiten referencat ose certifikatat për shërbimet e kryera (të përfunduara). a. Kur shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohet referenca të lëshuara nga autoriteti i tillë; b. Kur shërbimi është bërë për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i realizimit të tillë.

Pika 1 – Argument kundërshtues

Arsyetimi i AK-së:

Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën duke pretenduar se projekti i paraqitur “Nika Dent” nuk përmbush kërkesën e dosjes, pasi titulli i tij është “Instalimi i programit financiar/kontabilitet, menaxherial dhe administrativ” dhe nuk është specifikuar si projekt në shëndetësi.

Kundërshtimi ynë:

- **Kërkesa e dosjes së tenderit**
Dosja e tenderit përcaktonte që Operatorët Ekonomikë duhet të dëshmojnë të paktën një projekt të realizuar në sektorin e shëndetësisë gjatë tre viteve të fundit, duke pranuar si dëshmi edhe referenca nga institucione private shëndetësore. Kërkesa nuk e kufizonte formën apo titullin e projektit, por vetëm natyrën e tij – pra që të jetë i realizuar për një institucion shëndetësor.
- **Përmbushja e kërkesës nga ana jonë**
Projekti i paraqitur është i realizuar tek **Ordinanca Stomatologjike “Nika Dent”**, një institucion shëndetësor privat i licencuar, i cili ka lëshuar referencë të plotë mbi implementimin e sistemit informativ. Ky sistem përfshin module për menaxhim financiar, administrativ dhe të shërbimeve shëndetësore, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e çdo institucioni shëndetësor.
- **Vlerësimi i gabuar i AK-së**
Eliminimi është bërë mbi bazën e një interpretimi formalist të titullit të projektit, duke lënë anash përmbajtjen dhe qëllimin e tij real. Në praktikën e prokurimit publik, projektet duhet të vlerësohen sipas natyrës së aktivitetit dhe sektorit ku janë realizuar, jo sipas formulimit të titullit. Implementimi i një sistemi të plotë menaxhimi për një ordinancë stomatologjike është projekt tipik në sektorin e shëndetësisë.
- **Konkluzioni**
Projekti “Nika Dent” përmbush në mënyrë të plotë kërkesën e dosjes për një projekt në sektorin e shëndetësisë. Mospranimi i kësaj reference përbën interpretim të gabuar, cenon barazinë e operatorëve ekonomikë dhe dëmton konkurrencën në procedurë.

2.Arsyetimi i AK-Pika 2:

- Gjithashtu, për stafin profesional, në kuadër të dëshmimeve të kërkuara në NJK dhe DT është kërkuar edhe CV e nënshkruar nga inxhinieri, ndërsa të gjitha CV-të e ofruara nga OE CMD SH.P.K. janë pa nënshkrim të inxhinierëve perkates.

Edhe pse herën e parë këto e kemi konsideruar si devijim i vogël për shkak të çmimit me të lirë të ofertes, po edhe kjo është arsye për eliminim, meqenëse është e precizuar qartë me UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIT E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK - 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

Pika 2 – Argument kundërshtues mbi stafin e propozuar**Arsyetimi i AK-së:**

Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se stafi i propozuar nuk përmbush kriteret e dosjes së tenderit dhe në këtë bazë ka eliminuar ofertën tonë.

Kundërshtimi ynë:

- **Përmbushja e kërkesave të dosjes**
Dosja e tenderit ka kërkuar që Operatorët Ekonomikë të paraqesin CV të stafit të propozuar, me qëllim dëshmimin e kualifikimeve dhe përvojës profesionale të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuptim, të gjitha CV-të e paraqitura nga ne përmbajnë informacion të plotë dhe janë të përgatitura sipas formatit standard të kërkuar, duke dëshmuar kualifikimet akademike dhe eksperiencën relevante në fushën e teknologjisë së informacionit.
- **Aspekti ligjor i vlefshmërisë së CV-ve**
Në përputhje me kuadrin ligjor për prokurimin publik, dokumentet e kualifikimit duhet të jenë të qarta, të verifikueshme dhe të interpretohen në mënyrë proporcionale me objektin e kontratës. CV-të tona janë të përgatitura në përputhje me standardet ligjore dhe plotësojnë në tërësi kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.
Eliminimi i tyre mbi baza formale ose interpretim subjektiv nuk ka mbështetje ligjore, pasi kriteret ligjore dhe praktika e prokurimit publik kërkojnë që vlerësimi të bëhet mbi përmbajtjen e dokumenteve dhe jo mbi detaje formale që nuk ndikojnë në kapacitetin profesional të stafit.
- **Aspekti praktik i përmbushjes së kriterëve**
Nga përmbajtja e CV-ve rezulton qartë se stafi i propozuar ka formim akademik në fushën e informatikës dhe inxhinierisë së softuerit, trajnime profesionale, certifikime ndërkombëtare dhe përvojë praktike në projekte të ngjashme. Kjo është pikërisht ajo që ka kërkuar dosja e tenderit dhe përbën garanci se ekipi është plotësisht i aftë të realizojë kontratën.
Prandaj, çdo pretendim për mospërputhje është i pabazuar, pasi dokumentet tona dëshmojnë qartësisht kualifikimet dhe përvojën e kërkuar.
- **Konkluzioni**
CV-të e paraqitura janë në përputhje të plotë ligjore dhe praktike me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Eliminimi mbi këtë bazë është i padrejtë dhe bie ndesh me parimet e barazisë, proporcionalitetit dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë. Interpretimi formalist i AK-së nuk përputhet me kuadrin ligjor dhe praktikën e mirë të prokurimit publik, pasi përmbajtja e dokumentacionit tonë dëshmon qartë se stafi i propozuar i përmbush dhe i tejkalon kërkesat minimale të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Pika 3 – Mospërputhja në vlerën e shpërblimit

Arsyetimi i AK-së:

Në njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, në tabelën e hapjes së ofertave janë të shënuara vlerat:

- CMD SH.P.K. – 42,480.00 €
- DataProgNet SH.P.K. – 67,968.00 €

Megjithatë, në tekstin përfundimtar thuhet se kontrata i është shpërblyer OE "DataProgNet" SH.P.K. me vlerë 140,184.00 €, shifër që nuk përputhet me atë të ofertës së publikuar në tabelë.

Kundërshtimi ynë:

- **Mospërputhje faktike**

Ekziston një kontradiktë e qartë mes tabelës së ofertave dhe vlerës së shpërblimit të përmendur në vendim. Ndërsa në tabelë oferta e OE "DataProgNet" figuron me vlerë 67,968.00 €, në pjesën përfundimtare është shpallur si e shpërblyer me vlerën 140,184.00 €. Ky dallim jo vetëm që ngre dyshime mbi korrektësinë e procesit të vlerësimit, por përbën edhe element thelbësor për transparencën e procedurës.

- **Aspekti ligjor**

Kuadri ligjor i prokurimit publik kërkon që procesi të jetë i bazuar në dokumente të sakta dhe të përputhshme me procesverbalin e hapjes së ofertave. Çdo mospërputhje ndërmjet të dhënave të hapjes dhe atyre të shpallura si përfundim, cenon parimin e transparencës dhe lë hapësirë për keqinterpretim apo manipulim. Një vendim i tillë bie në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

- **Aspekti praktik**

Ky gabim ndikon drejtpërdrejt në besueshmërinë e procesit. Nëse vlera reale e ofertës së shpërblyer është 67,968.00 €, atëherë shifra 140,184.00 € është një gabim evident që kërkon korrigjim të menjëhershëm. Nëse vlera e ofertës është rritur për arsye që nuk janë sqaruar, atëherë kemi të bëjmë me një shkelje të parimeve themelore të prokurimit publik.

- **Konkluzioni**

Kjo mospërputhje përbën një arsye të fortë për rishqyrtimin e vendimit, pasi është shkelur parimi i transparencës dhe i barazisë. Vendimi për shpërblim nuk është i qartë dhe nuk përputhet me dokumentet e hapjes së ofertave, gjë që e bën atë të cenueshëm si në aspektin ligjor, ashtu edhe në atë praktik.

Nga analiza e vendimit të Autoritetit Kontraktues, rezulton se arsyet e eliminimit të ofertës sonë janë të bazuara mbi interpretime formale dhe gabime të vogla në administrimin e dokumenteve, të cilat nuk kanë ndikim thelbësor në përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit. Konkretisht:

- Projekti i paraqitur në sektorin e shëndetësisë është vlerësuar në mënyrë të gabuar si i papërshtatshëm, ndonëse referenca e lëshuar nga një institucion shëndetësor privat dëshmon qartë përmbushjen e kërkesës.
- CV-të e stafit janë eliminuar për arsye formale, megjithëse përmbajtja e tyre është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe praktike të dosjes së tenderit.
- Ekziston një mospërputhje e dukshme ndërmjet tabelës së hapjes së ofertave dhe vlerës së

shpërblimit të publikuar në vendim, duke cënuar qartësinë dhe transparencën e procedurës.

Të gjitha këto janë elemente që, në vend që të çojnë në eliminim, duhej të ishin adresuar përmes qartësimi dhe korrigjimit, siç parashikon vetë kuadri ligjor i prokurimit publik.

Në këtë kontekst, duhet theksuar se parimi themelor i Ligjit për Prokurimin Publik është “vlera për para” – siguria se fondet publike shpenzohen në mënyrë sa më efikase dhe në interesin më të mirë të Autoritetit Kontraktues dhe qytetarëve. Në rastin konkret, oferta jonë ka qenë dukshëm më e favorshme ekonomikisht (42,480.00 €) në krahasim me ofertën e shpërblyer (e publikuar si 67,968.00 € dhe në mënyrë të paqartë si 140,184.00 €). Përfundimi i një oferte më të ulët, që përmbush të gjitha kërkesat ligjore dhe teknike, për arsye formale, është në kundërshtim me këtë parim dhe sjell dëm të drejtpërdrejtë për buxhetin publik.

Përfundimisht, vendimi i marrë nga Autoriteti Kontraktues është i cënueshëm si në aspektin ligjor, ashtu edhe në atë praktik. Ne kërkojmë që ky vendim të rishqyrtohet, duke marrë parasysh përmbushjen e plotë të kriterëve nga ana jonë dhe duke rivlerësuar ofertën tonë në përputhje me parimin e “vlerës për para” dhe me parimet e barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë.

Në fund, pasi të verifikohen të gjitha pretendimet tona ankimore, kërkojmë nga ana e Autoritetit Kontraktues që të nxjerrë një vendim të ri, i cili garanton një procedurë të drejtë, transparente dhe në përputhje me ligjin, duke siguruar rivlerësimin proporcional të ofertës sonë dhe mbrojtjen e barazisë së operatorëve ekonomikë.

Në fund pasi që të vërtetohen të gjitha pretendimet tona ankimore, kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktues që të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e **CMD SH.P.K.**

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës (B58) dhe lënda kthehet në

RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe konsiderojme se pretendimet e juaja ankimore janë të pa bazuara.

AK-MSh duke marrë parasysh ankesën paraprake të datës 05.08.2025 të adresuar nga kompania konkurente DataProgNet SHPK e ka bërë rivlerësimin e aktivitetit dhe bazuar në pretendimet ankimore dhe ofertën tuaj, gjatë rivlerësimit ka konstatuar mangesitë e cekura në B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, të datës 12.09.2025.

AK-MSh i konfirmon arsyet e eliminimit të cekura në Letren Standarde B42 të datës 12.09.2025.

Oferta juaj është e papërgjegjshme, meqenëse nuk i ka plotësuar dy kërkesa të NJK dhe DT.

- Të kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 – Kërkesa nr. 1 është kërkuar: ***Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar se paku një projekt në zhvillimin dhe implementimin ose mirëmbajtje të softuerit e të paktën 1 (një) projekti në shëndetësi tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të këtij Njoftimit për kontratë.***

Në Listën e projekteve të prezantuara nga OE CMD SH.P.K. është edhe projekti nr. 4 me titullin **Instalimi i programit financiar/kontabilitet, menaxherial dhe administrativ 2022-2024** në vlerë 5,980.00 euro për Ordinancën stomatologjike “Nika Dent”

Pas shqyrtimit me të detajuar të kërkesës së AK dhe dokumentacionit të ofertes, konsiderojmë se ka dallim substancial në mes titullit të projektit në listë dhe përshkrimit të bërë në referencë. Sipas Listës projekti është realizuar nga 2022 deri në 2024, ndërsa referenca është lëshuar më dt. 01.06.2025 (pese dite para ofertimit 06.06.2025).

Për shqyrtimin me të detajuar të këtij projekti, kemi konsultuar dokumentacionin e ofruar nga kjo kompani në aktivitetin me titull “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ” për të cilin OE ka prezantuar sistemin e njejtë CMD-Financa, në të cilin nuk përfshihet përmbajtje e komponentave për shëndetësi, por është sistem financiar.

- Gjithashtu, për stafin profesional, në kuadër të deshmive të kërkuara në NJK dhe DT është kërkuar edhe **CV e nënshkruar nga inxhinieri**, ndërsa të gjitha CV-të e ofruara nga OE CMD SH.P.K. janë pa nënshkrim të inxhinierëve përkatës.

Edhe pse herën e parë këto e kemi konsideruar si devijim i vogël për shkak të çmimit me të lirë të ofertes, po edhe kjo është arsye për eliminim, meqenëse është precizuar qartë me UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK - 10. **Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve**

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtëjshëm	69
--	---	----

Duke marrë parasysh dallimin e konsiderueshëm në çmimin e ofertes tuaj krahasuar me OE të rekomanduar, në si AK herën e parë u kemi shpallë fitues, duke i trajtuar mangesitë si devijime të vogla, por meqenëse ato janë atakuar me ankesë dhe gjatë vlerësimit janë shqyrtuar detajsisht dhe është konfirmuar se oferta juaj është e papërgjegjshme.

Sa i perket pretendimit rreth vlerës 140,184.00 € te specifikuar ne Njoftimin mbi vendimin e AK, te datës 12.09.2025, ju sigurojmë se eshte bere gabim teknik nga ana jone gjate përdorimit te formës se njoftimit si draft nga tjetër aktivitet dhe kjo do te korrigjohet nga ana jone.

Titulli i kontratës i dhënë nga AK: Ritender "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN" Lot 2 - Medlis

Numri i Prokurimit:	206-25-5404-2-2-1
---------------------	-------------------

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ne Euro (€)
1	<u>CMD SH.P.K., Prishtinë, N. Terezë 40a Nr. 2, 10000, Prishtinë, Kosovë</u>	42,480.00 €
2	<u>"DataProgNet" SH.P.K., Rr. Qamil Ilazi, Nr.16, 70000, Ferizaj</u>	67,968.00 €

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Shëndetësisë shpërblen me kontratë operatorin ekonomik **"DataProgNet" SH.P.K.** ne vlerën e ofertës **140,184.00 €**.

Vlera e ofertës se OE nuk mund te shtohet as për një cent dhe ajo eshte saktësisht **67,968.00 €**, siç eshte specifikuar edhe ne Letrën Standarde B45 dërguar te OE i rekomanduar.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm¹

12.09.2025, Prishtinë

Ministria e Shëndetësisë – rr. e Zagrebit nr. 60, ish spitali i mushkërive, lagja Arbëria
"DataProgNet" SH.P.K. Rr. Qamil Ilazi, Nr.16, Ferizaj

Numri i Prokurimit:	206-25-5404-2-2-1
---------------------	-------------------

Titulli: **Ritender "Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemeve Medlis dhe SMSN" Lot 2 - Medlis**

I nderuar z. Naser Shabani,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët si përgjigje ndaj njoftimit të kontratës për aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Ju ve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj ne ofertën e dorëzuar në vlerë të përgjithshme të ofertës 67,968.00 € dhe në pajtim me alatet dhe kushtet e dosjes së tenderit .

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin të intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Me respekt,

Berat Marmullaku
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)

Ne baze te sqarimeve te lartcekura, AK-MSh konsideron se pretendimet e juaja ankimore per eliminimin tuaj jane te pa bazuara, ndersa per vlerën e ofertes se rekomanduar 140,184.00 €, eshte gabim teknik qe do korrigohet per fituesin ne vleren e ofertes **67,968.00 €**.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit